



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupšina Opštine Orahovac / Municipal Assambly Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA PROCESVERBAL

Mbledhja e katërt e Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e mbajtur më datë 26.06.2025 (e enjte), me fillim në ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e komitetit, **Samra Kërqagu**. Të gjithë anëtarët e komitetit ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vizitë në organizatën OPFAK-RAHOVEC;
3. Të ndryshme.

Kryesuesja: Mirëmëngjesi, përshëndetje për të gjithë! Jemi mbledhur sot në takimin e katërt të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2025. Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës. Atëherë, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim! Kush është “pro”?... Unanimisht aprovet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesja: Atëherë, nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është pro? Unanimisht aprovet edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Selman Shtavica: Unë personalisht nuk e kam ditur që në mbledhjen e kaluar do të jetë i pranishëm Lulëzim Krasniqi.

Skender Hamza: Selman, mbledhjet janë të hapura për publikun. Mund të jenë të pranishëm edhe qytetarët, veçse nuk kanë të drejtë vote. Kryesuesja e komitetit e bën rendin e ditës dhe në bashkëpunim me zëvendëskryesuesin e fton mbledhjen, pastaj ju debaton dhe merreni vesh.

Kryesuesja: Selman, herën tjetër do t’ju njoftojmë në detaje, por mos harro që rendi i ditës të vjen në email një javë më herët.

Atdhe Rama: Në mbledhjen e kaluar si pikë e dytë e rendit të ditës ka qenë: Shqyrtimi i kërkesës së OPFAK-Rahovec. Doktor Lulëzimi ka pasur qejf të jetë i pranishëm dhe të shoh nga afër se si po rrjedh mbledhja dhe biseda rreth kërkesës së tij, për t’u bërë me një vend administrativ për shoqatën OPFAK-Rahovec.


2. Vizitë në organizatën OPFAK-RAHOVEC:

Kryesuesja: Atëherë, si pikë e dytë e kemi vizitën në organizatën OPFAK-Rahovec, në ambientet e SHL – Kosova, ku për momentin është e vendosur.


3. Të ndryshme:

Kryesuesja: Nëse nuk ka dikush diçka për te pika e fundit, atëherë po shkojmë për realizimin e vizitës. Ju falënderoj për vëmendjen dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi

Kryesuesja e komitetit


Samra Kërqagu

